



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 05 prot.

Kamëz, më 23.01. 2023

V E N D I M

Nr 05 Datë 23.01 / 2023

“MIRATIMIN E KRITEREVE PËR TRAJTIMIN ME NDIHMË EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË NGA BUXHETI BASHKISË PËR VITIN 2023”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 23.01.2023, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.05 Datë 19.01.2023 në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, nenit 21 të Ligjit nr. nr.57 datë 18/07/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë, Kreut IV, të vendimit nr. 597 datë 04/09/2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, dhe në VKB nr.163 dt.21.12.2022 “Mbi miratimin e Projekt - Buxhetit afat mesem të Bashkisë Kamëz (PBA)” për vitin 2023, 2024, 2025; ”, Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e kriterëve për trajtimin me Ndhmë Ekonomike të familjeve në nevojë nga fondet e buxhetit lokal si më poshtë vijon:
 - a. Familje me fëmijë jetim.
 - b. Familje që jetojnë në kushte të varfërisë ekstreme.
 - c. Të moshuar që janë të vetmuar dhe pa kujdestari.
 - d. Familje me persona invalid dhe kushte shumë të vështira pa të ardhura të tjera.
 - e. Familje me kryefamiljarë në burg dhe fëmijë të vegjël.
 - f. Gra me probleme dhune në familje.
 - g. Familje që kanë probleme të mëdha shëndetësore dhe kërkojnë ndërhyrje të rënda kirurgjikale etj.
 - h. Familje që kanë fatkeqësi njerëzore dhe natyrore.
 - i. Familje që nuk kanë banesë të tyre dhe janë pa të ardhura.
 - j. Familje që kanë banesë të dëmtuar për arsye madhore.
2. Në këtë skemë do të përfshihen familjet që verifikohen për situatën ekonomike nga grupi i punës i drejtorisë së ndihmës ekonomike në bashkëpunim me komisionin e Këshillit Bashkiak.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

3. Masa e përfitimit do jetë sipas rasteve në konsultim me titullarin e institucionit dhe komisionin e ekonomisë të Këshillit Bashkiak, bazuar në fondin e vënë në dispozicion.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

